

1 KRYERJA E TESTIT

Në momentin e kryerjes së testit, hiqni shkopin e testit nga mbështjellja prej letre dhe hiqni kapakun me ngjyrë blu. Përdorni menjëherë shkopin e testit.

OSE KRYENI TESTIN NË RRJEDHËN E URINËS SUAJ

- Thjesht poziciononi marrësin absorbues të ekzemplantit duke e vendosur me drejtim nga poshtë në rrjedhën tuaj të urinës **për vetëm 5 sekonda.**
- Kujdesuni që të mos laget pjesa tjetër e testit.
- Mund të lindë nevoja që të rivendosni kapakun dhe ta vendosni shkopin e testit të pozicionuar drejt.



OSE MBLIDHNI NJË EKZEMPLAR TË URINËS TUAJ NË NJË ENË TË THATË E TË PASTËR

- Thjesht poziciononi marrësin absorbues të ekzemplantit duke e vendosur me drejtim nga poshtë në urinën tuaj **për vetëm 20 sekonda.**
- Mund të lindë nevoja që të rivendosni kapakun dhe ta vendosni shkopin e testit të pozicionuar drejt.



Gjatë gjithë kryerjes së testit mos e mbani **asnjëherë** shkopin e testit me marrësin absorbues të ekzemplantit të pozicionuar me drejtim nga lart.

2 PRISNI...

- Simboli i pritjes do të pulsojë duke treguar se testi funksionon.
- Rezultati do të shfaqet kur simboli i pritjes të mos pulsojë më. Nëse simboli i pritjes nuk shfaqet pas përdorimit të testit, referojuni gabimet e testit në seksionin 'Pyetje dhe Përgjigje'.



3 SHIHNI REZULTATIN TUAJ

Testi i Shtatzënisë Clearblue® DIGITAL ka një **Tregues të Javëve** i cili ofron një vlerësim të kohës se kur mund të keni mbetur shtatzënë. Ky informacion shfaqet në ekran së bashku me rezultatin 'Shtatzënë'.

- Brenda **3 minutash**, ekrani do të shfaqë rezultatin tuaj.
- Një rezultat 'Shtatzënë' mund të shfaqet në ekran **përpara** rezultati të Treguesit të Javëve. **Vazhdoni të prisni** derisa simboli i pritjes të pushojë së pulsuarit për të parë rezultatin e Treguesit të Javëve. Kjo procedurë mund të zgjasë deri në 3 minuta.
- Disa rezultate mund të shfaqen në më pak se 1 minutë.
- Rezultati do të mbetet në ekran për një periudhë rreth 24 orëshe.
- Nëse testi konfirmon se jeni 'Shtatzënë', ju duhet të takoni mjekun tuaj i cili mund t'ju këshillojë për veprimet dhe hapat që duhet të ndërmerri në të ardhmen. Mjeku do të llogarisë stadin tuaj aktual të shtatzënisë bazuar në ditën e parë të periodeve tuaja të fundit.
- Ngjizja ndodh rreth 2 javë përpara ardhjes së periodeve tuaja të ardhshme. Treguesi i Javëve mundëson llogaritjen e kohës se kur keni mbetur shtatzënë.
- Treguesi i Javëve ka një saktësi prej 93% i në zbulimin e periudhës së fillimit të shtatzënisë. Vlerësimi është bazuar në nivelin e hormonit të shtatzënisë hCG, (Gonadotropina Korionike njerëzore), në urinën tuaj. Niveli i hCG-së ndryshon në varësi të trupit të femrave të ndryshme dhe për këtë arsye mund të ndodhë që Treguesi i Javëve herë pas here të japë rezultate jo të vërteta. Saktësia e rezultati 'Shtatzënë'/'Jo Shtatzënë' e kalon 99% kur testi kryhet duke filluar nga dita e periodeve tuaja të pritshme.

Si duhen interpretuar rezultatet

Rezultatet	Koha që nga periudha e ngjizjes	Si do ta përcaktojë mjeku juaj datën e shtatzënisë (në bazë të ciklit 28 ditor)*
	Rezultati juaj është 'Jo Shtatzënë' referojuni pyetjes 10 në seksionin 'Pyetje dhe Përgjigje'.	-
	Rezultati juaj është 'Shtatzënë' dhe ju keni mbetur shtatzënë për afërsisht 1-2 javë më parë.	3-4 javë
	Rezultati juaj është 'Shtatzënë' dhe ju keni mbetur shtatzënë rreth 2-3 javë më parë.	4-5 javë
	Rezultati juaj është 'Shtatzënë' dhe ju keni mbetur shtatzënë më tepër se 3 javë më parë.	5+ javë

*Mjeku juaj do të përcaktojë datën e shtatzënisë duke filluar nga dita e parë e periodeve të fundit, jo nga dita kur keni mbetur shtatzënë.

Gabimet e Testit

Ju lutem lexoni seksionin 'Gabimet e Testit' nëse keni përdorur shkopin e testit dhe ekrani nuk shfaq asnjë rezultat në këtë faqe.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

1 Si funksionon testi i shtatzënisë Clearblue® DIGITAL?

Gjatë shtatzënisë trupi juaj prodhon hormonin e shtatzënisë hCG (Gonadotropina korionike njerëzore). Niveli i hCG-së në trupin tuaj pëson rritje në fazat e hershme të shtatzënisë. Clearblue® është në gjendje të zbulojë sasi shumë të vogla të këtij hormoni në urinën tuaj (ndjeshmëria e këtij testi është 25 mIU/ml) Treguesi i Javëve mundëson një vlerësim të datës së ngjizjes tuaj në bazë të nivelit të hCG-së në urinën tuaj.

2 Cila është shkalla e saktësisë së testit të shtatzënisë Clearblue® DIGITAL në zbulimin e shtatzënisë?

Në analizat laboratorike testi i shtatzënisë Clearblue® DIGITAL ka një saktësi që tejkalon 99% në zbulimin nëse jeni apo jo shtatzënë, kur përdoret nga data e periodeve të pritshme. Nëse kryeni testin para datës së periodeve të pritshme dhe merrni rezultatin 'Jo Shtatzënë', ka ende mundësi që të jeni shtatzënë. Referojuni pyetjes 4.

3 Sa i saktë është Treguesi i Javëve i Testit të Shtatzënisë Clearblue® DIGITAL?

Treguesi i Javëve ka një saktësi 93% në zbulimin e kohës kur keni mbetur shtatzënë. Vlerësimi është bërë në bazë të nivelit të hCG-së në urinën tuaj. Niveli i hCG-së ndryshon në varësi të trupit të femrave të ndryshme dhe për këtë arsye mund të ndodhë që treguesi i javëve ndonjëherë të japë rezultate jo të vërteta. Treguesi i javëve ka tregues se është 97% në përputhje me vizitën e mëvonshme të skanerit me ultratinguj (11-13 javë). Kjo është bazuar në rezultatet krahasuese të studimeve të bëra në një grup prej 187 grash (1-2, 2-3, 3+ javë që nga ngjizja) në vizitën me ultratinguj. Nëse po e kryeni testin përtej periudhës 6 javore pas ngjizjes, Treguesi i Javëve mund të japë rezultate të paparashikuara. Kjo ndodh për shkak se niveli i hCG-së në urinë është shumë i lartë që testi të realizojë një vlerësim të saktë të kohës së ngjizjes.

4 Kur mund ta kryej Testin e Shtatzënisë Clearblue® DIGITAL?

Testi i Shtatzënisë Clearblue® DIGITAL mund të përdoret deri në 5 ditë para periodeve të munguara (që është 4 ditë para periodeve të pritshme). Nëse kryeni testin para datës së periodeve të pritshme dhe merrni rezultatin 'Jo Shtatzënë', ka ende mundësi që të jeni shtatzënë. Shihni tabelën e mëposhtme për rezultatet e arritura nga testimet klinike të testit të shtatzënisë Clearblue® DIGITAL me ekzemplantë të hershëm të shtatzënisë.

Testimi i parakohshëm	
Numri i ditëve para periodeve të pritshme	% e ekzemplantëve të marrë nga gratë shtatzëna që kanë marrë rezultatin 'Shtatzënë'
-1	98%
-2	97%
-3	90%
-4	65%

Nëse rezultati është 'Jo Shtatzënë' dhe ende dyshohet për shtatzëni të mundshme, referojuni pyetjes 10. Për të gjetur ditën kur priten periodat, llogaritni kohëzgjatjen e zakonshme të ciklit tuaj menstrual duke numëruar numrin e

ditëve nga dita e parë e periodeve deri në ditën që i paraprind fillimit të periodeve të ardhshme.

- Nëse keni cikle të rregullta, duhet të merrni në konsideratë ciklin më të gjatë në muajt e fundit para kryerjes së testit.
- Nëse nuk e dini kohën e periodeve, ju rekomandojmë kryerjen e testit jo më pak se 19 ditë pas herës së fundit gjatë të cilës keni pasur marrëdhënie seksuale të pambrujtur.

5 A ka mundësi që ndonjë ilaç ose probleme të caktuara mjekësore të ndikojnë në rezultatin e testit?

- Lexoni gjithmonë udhëzimet e prodhuesit për çdo mjekim që merrni përpara kryerjes së testit.
- Ilaçet e fertilitetit me përmbajtje hCG-je mund të çojnë në rezultate të gabuara (këto ilaçe fertiliteti zakonisht jepen me injeksion dhe kryerja e testit brenda një kohe të shkurtër pas injeksionit mund të japë një rezultat të rremë 'Shtatzënë').
- Terapitë e tjera të fertilitetit (të tilla si citrat klomifeni), gëdësuesit e dhimbjeve dhe kontrceptivët hormonalë (p.sh. pillula kontrceptive) nuk duhet të ndikojnë në rezultat.
- Nëse kohët e fundit nuk përdorni më kontrceptivët hormonalë ose po përdorni terapi fertiliteti si citrat klomifeni, periudat tuaja mund të jetë të rregullta, duke ju çuar në kryerjen e parakohshme të testit.
- Nëse keni qenë kohë e fundit shtatzënë (edhe në rast se keni dështuar), mund të merrni një rezultat të rremë 'Shtatzënë'.
- Nëse po hyni në menopauzë mund të merrni një rezultat të rremë 'Shtatzënë' edhe pse nuk jeni shtatzënë.
- Shtatzënia ektopike dhe menopauza mund të çojnë në rezultate çorientuese/Jo të vërteta.
- Shtatzënitë e shumëfishta dhe ektopike mund të japin rezultate çorientuese/Jo të vërteta të Treguesit të Javëve. Nëse keni rezultate të paparashikuara, duhet t'i diskutoni ato me doktorin tuaj.

6 Testi im thotë se unë jam 'Shtatzënë'. Çfarë duhet të bëj?

Nëse testi konfirmon se jeni 'Shtatzënë', ju duhet të takoni mjekun tuaj i cili mund t'ju këshillojë për veprimet dhe hapat që duhet të ndërmerri në të ardhmen. Treguesi i Javëve jep thjesht një vlerësim për kohën se kur ka ndodhur ngjizja. Mjeku juaj do të vlerësojë stadin aktual të shtatzënisë tuaj në bazë të ditës e parë të periodeve tuaja të fundit. Ngjizja ndodh rreth 2 javë para ardhjes së periodeve tuaja të ardhshme.

7 Testi im thotë se unë jam shtatzënë, por nuk mendoj se kam mbetur shtatzënë në kohën kur Treguesi i Javëve thotë se ka ndodhur kjo. A mund të ndodhë kjo?

Treguesi i Javëve ka një saktësi prej 93% kur testi kryhet me urinën e parë të ditës. Disa ilaçe ose probleme mjekësore mund të ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Referojuni pyetjes 5.

8 Këna testin në fillim dhe mora rezultatin 'Shtatzënë', por pas një testi të dytë mora rezultatin 'Jo Shtatzënë', ose më kanë filluar periadat. Çfarë do të thotë kjo?

Megjithëse testi ka një saktësi që tejkalon 99% për zbulimin e hormonit të shtatzënisë nga dita e periodeve të pritshme, ka të ngjarë të merrni një rezultat që tregon se jeni shtatzënë dhe të zbuloni më pas se nuk jeni (pra, më pas mund të merrni një

rezultat 'Jo Shtatzënë', apo mund t'ju fillojnë periadat). Kjo mund të vijë si pasojë e humbjes natyrore gjatë fazave të hershme të shtatzënisë, i njohur si 'dështim në shtatzëni dhe hershme', që fatkeqësisht ndodh rëndom, duke qenë se rreth 1 në 4 shtatzëni përfundon në dështim në shtatzëni dhe hershme. Nëse keni rezultate të paparashikuara, duhet t'i kërkonit këshilla mjekut tuaj.

9 U testova më parë dhe rezultati ishte 'Shtatzënë'. E kreu përsëri testin dhe sipas Treguesit të Javëve numri i javëve që nga koha e ngjizjes është reduktuar. Çfarë duhet të bëj?

Në rast se e keni kryer testin në përputhje me udhëzimet e dhëna, duke përdorur urinën e parë të ditës në të dyja rastet, dhe treguesi i javëve ka dhënë rezultate të paparashikuara, duhet të vizitoheni te mjeku.

10 Testi im thotë se unë jam 'Jo Shtatzënë'. Çfarë duhet të bëj?

Ju mund të mos jeni shtatzënë, ose niveli i hormonit të shtatzënisë mund të mos jetë ende mjaft i lartë aq sa për t'u zbuluar, ose mund të keni llogaritur gabim ditën e periodeve të pritshme.

- Nëse e keni kryer testin herët, testohuni përsëri në kohën kur priten ardhja e periodeve.
- Nëse ka vonesë në ardhjen e periodeve, kryeni përsëri testin brenda 3 ditësh. Nëse ky test rezultoi 'Jo Shtatzënë' dhe ende nuk ju vijnë periadat, bëni një vizitë te mjeku juaj.

GABIMET E TESTIT

Gabim regjistrimi - ka ndodhur një gabim gjatë kryerjes së testit. Kjo mund të shkaktohet për arsye se:

- Marrësi absorbues të ekzemplantit nuk u mbajt me drejtim nga poshtë apo testi nuk u pozicionua horizontalisht pas aplikimit të urinës.
- Është përdorur më shumë ose më pak urinë se sa duhet. Ju duhet ta kryeni përsëri testin, duke përdorur një test të ri dhe duke u përqëndruar në ndjekjen e udhëzimeve.

Gabim bosh - Testi nuk është kryer siç pritej. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak se nuk janë ndjekur udhëzimet e përdorimit. Ju nevojitet të kryeni një test tjetër. Ju lutemi ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.

ASGJËSIMI I TESTIT

Hiqni baterinë përpara se të procedoni me asgjësimin e shkopit të testit. Eliminimi i baterisë duhet të bëhet në përputhje me skemën përkatëse të riciklimit. Për ta hequr atë, futni një monedhë në të çarën në fund dhe rrotullojeni për të hapur pjesën e prapme të shkopit të testit. Nëse bateria nuk është e dukshme, rreshtiqni mbajtësin e baterisë në drejtim të shigjetës për të ndihmuar me heqjen e saj. **Kini parasysh:** Mos i çmontoni, rikarikoni ose mos i hidhni bateritë në zjarr. Eliminoni pjesën e mbetur të shkopit në përputhje me skemën e duhur të riciklimit për pajisjet elektrike. Mos i hidhni pajisjet elektrike në zjarr.

CE 0843 Kjo pajisje përmbush kërkesat për emetimet elektromagnetike të EN61326. Emetimi elektromagnetik i saj për këtë arsye është i ulët. Nuk priten ndërhyrje nga pajisje të tjera që funksionojnë me energji elektrike. Ky test nuk duhet të përdoret në afërsi të burimeve të rrezatimit të fortë elektromagnetik, p.sh. pranë telefonave celularë, duke qenë se këta të fundit mund ta pengojnë testin që të funksionojë siç duhet. Për të shmangur shkakimet elektrosztatike, mos e përdorni testin në një mjedis shumë të thatë, veçanërisht aty ku janë të pranishme materiale sintetike.

Test shtatzënie në kushtet e shtëpisë. Jo për përdorim të brendshëm. Mbajeni larg fëmijëve. Lëreni testin të arrijë temperaturën e dhomës për 30 minuta para kryerjes së testit në rastet kur ai ruhet në frigorifer. Mos e përdorni nëse mbështjellja prej letre që ka brenda shkopin e testit është e dëmtuar. Mos e përdorni nëse shkopi të testit i ka kaluar afati i skadimit. Ky produkt i përfshin bateritë. Asgjësimi bëhet në përputhje me rregulloret lokale. Këto udhëzime jepen për modelin numër CB9A002.

www.clearblue.com

SPD Swiss Precision Diagnostics GmbH (SPD), Route de St Georges 47, 1213 Petit-Lancy, Gjenevë, Zvicër. Clearblue është markë tregtare e SPD. © 2015 SPD. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Prodhuar në Kinë

Shpërndarë nga: OVLAŠTENI ZASTUPNIK ZA RH: Orbico d.o.o., Koturaška 69, Zagreb, Kroaci

	Pajisje mjekësore diagnostikuese in vitro		Kodi i ngarkesës		Ndalohet ripërdorimi
	Limiti i temperaturës 2°C - 30°C		Përdorimi deri në datën:		Prodhuesi
			Konsultohuni me udhëzimet e përdorimit		